



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1653 datë 18.07.2011

Për

“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Albtelecom sh.a.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 18.07.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Albtelecom sh.a.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, dhe neni 60 e vijues, pika të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Neni 46, e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore nr. 19 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17, e nenit 21, të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138, të ligjit nr. 9918,

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e Abissnet sh.a., me nr. 3523, datë 28.06.2011, (AKEP: 1031 prot, datë 28.06.2011), “*Kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes lidhur me draft marrëveshjen e interkoneksionit midis shoqërisë Abissnet sh.a dhe Albtelecom sh.a*”;
- Korespondenca shkresore midis sipërmarrësve;
- si dhe,
duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

Abissnet sh.a., me anë të shkresës nr. 3523, datë 28.06.2011, (AKEP: nr. 1031 prot, datë 28.06.2011), “*Kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes lidhur me draft marrëveshjen e interkoneksionit midis shoqërisë Abissnet sh.a dhe Albtelecom sh.a*”, sqaron si më poshtë vijon:

1. Abissnet argumenton se, një nga arsyet se përse nuk ka pranuar të nëshkruajë draft marrëveshjen e interkoneksionit me Albtelecom është se, marrëveshja e interkoneksionit e publikuar në faqen e internet-it të Albtelecom, nuk është miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP;
2. Abissnet sqaron se, në draft marrëveshjen e interkoneksionit të paraqitur nga Albtelecom, parashikohet detyrimi i Abissnet për të paguar një tarifë mujore për çdo lidhje 2 Mbps ose pagesa për qarkun E1 (të tre qarqet E1), Abissnet vlerëson se ky detyrim është i papapranueshëm pasi Abissnet ka investuar për realizimin dhe instalimin e këtij qarku duke përballuar vetë kostot dhe duke kryer të gjitha punimet e nevojshme për realizimin e instalimit të Qarkut E1, pra për interkoneksionin midis sipërmarrësve Abissnet dhe Albtelecom përdoret infrastruktura e shoqërisë Abissnet;
3. Abissnet thekson se, me anë të shkresës nr. 2323 prot, datë 30.04.2011 i është drejtuar Albtelecom duke i kërkuar ndryshimin e nenit 17, pika 5 të draft marrëveshjes së interkoneksionit si më poshtë vijon:

“Nëse operatori përfitues nuk kryen pagesat brënda afatit të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni atëhere do të aplikohet kamatvonesa në masën 0.05% të vlerës së shumës së detyruar për çdo ditë kalendarike që tejkalohet ky afat, por jo më shumë se 5% e vlerës së detyruar”

Për sa më sipër Abissnet konsideron se, në ORI e publikuar nga Albtelecom parashikohet kamatvonesë 0.5 % e vlerës së detyruar por jo më shumë se 10 ditë, rezulton se kamatvonesa që kërkon të aplikojë Albtelecom është rreth 15 herë më e lartë se interesat bankare që zbatojnë bankat e nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë;

4. Abissnet mbi shkresën nr. 2735, datë 14.06.2011 të Albtecom “*Për përditësimin e zonave ndërkombëtare dhe tarifave përkatëse*”, me anë të së cilës Albtelecom ka përcaktuar detyrimet e operatorëve Alternativë për terminimin dhe tranzitimin e trafikut në rrjetin e operatorëve ndërkombëtar nëpërmjet rrjetit të tij, aplikimi i të cilave hynë në fuqi më datë 01.07.2011, Abissnet shpreh jo dakortësinë për aplikimin e këtyre tarifave ndaj operatorëve alternative, për këto arsye:

- Analiza e çmimeve të trafikut ndërkombëtar tregon një rritje prej 1.91–3.62 herë, ndërsa tarifa e thirrjeve të sukseshme është rritur 23 herë;
 - Albtelecom kërkon të vendos tarifën e trafikut të operatorëve alternative të cilat duhet të vendosen nga Operatorët Alternativë;
 - AKEP ka propozuar që tarifën e operatorëve alternative duhet të jenë 30% më të larta se ato të Albtelecom;
5. Abissnet thekson se, nuk është e drejtë që tarifën për të gjitha llojet e thirrjeve ndërkombëtare të tranzituara nga operatori përfitues, pavarësisht se ku terminohen këto thirrje në rrjetin e Albtelecom (segment lokal, njëfish apo dyfish) janë të barabarta me tarifën e thirrjeve që gjenerohen nga operatori dhe terminohen në rrjetin e Albtelecom sipas kategorisë “*Terminim në segment dyfish të kombëtar*”. Trafiku që gjenerohet nga operatori përfitues ashtu edhe trafiku ndërkombëtar që tranzitohet prej tij, mund të terminohen në rrjetin e Albtelecom sipas kategorive segment lokal, segment i njëfish të apo segment i dyfish të, si rrjedhojë meqënëse trafiku që gjenerohet nga operatori përfitues dhe terminohet në rrjetin e Albtelecom tarifohet me tre tarifa të ndryshme në përputhje me kategoritë e segmenteve përkatës të trafikut, ashtu edhe trafiku ndërkombëtar që tranzitohet nga operatori duhet të tarifohet sipas segmentit përkatës dhe jo me një tarifë të vetme dhe pikërisht me atë të trafikut që terminohet sipas segmentit dyfish të;
 6. Abissnet konsideron se, nga Albtelecom nuk kanë marrë asnjë shkresë për lehtësimin e kushteve të marrëveshjes, dhe se aktualisht Abissnet është pa marrëveshje interkoneksioni me Albtelecom sh.a;
 7. Abissnet vlerëson se, kjo situatë është e pafavorshme për Abissnet dhe se janë të interesuar në lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit me Albtelecom por në pikat e mësipër cituara më të lehtësuara;
 8. Sipërmarrësit Abissnet sh.a. dhe Albtelecom sh.a., megjithë përpjekjet e bëra, nuk kanë arritur të bien dakord për nëshkrimin e marrëveshjes së interkoneksionit, AKEP në zbatim të nenit 50, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, zgjidhja e mosmarrëveshjes mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me iniciativën e AKEP,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Albtelecom sh.a;
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me përbërje si:
 - Altin RRAPAJ Kryetar
 - Jonida GJIKA Anëtar

- Florida ÇELA Anëtar
- Esmeralda DERVISHI Anëtar
- Xhenisa NELA Anëtar

3. Të njoftohen palët e interesuara Abissnet sh.a. dhe Albtelecom sh.a për fillimin e procedimit administrativ;
4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit të vendimit;
5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**